



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr.104/02 - 29676/20
Kaçanik, 24.12.2020

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 24 Dhjetor 2020, pos tjerash;

NJOFTOHET

- 1.Me Raportin e Punës së Shtabit Komunal për Parandalimin e Covid-19.
2. Në Raportin si në pikën 1 të kësaj shkrese janë paraqitur aktivitetet e zhvilluara nga Shtabi Komunal për Parandalimin e Covid-19, lidhur me menaxhimin e situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19 , si dhe sfidat për parandalimin e kësaj pandemie.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është; “Raporti i Punës së Shtabit Komunal për Parandalimin e Pandemisë COVID-19 për Kuvendin Komunal në Kaçanik”, Lënda 01Nr.104/02-29676/20.

Më këtë shkrese njoftohen: Kryetari i Komunës, dhe përmes zyrës së Kryetarit njoftohen edhe Drejtoritë komunale dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr.104/02 - 29676/20
Kaçanik, 24.12.2020

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 24 Dhjetor 2020, pos tjerash;

NJOFTOHET

- 1.Me Raportin e Punës së Shtabit Komunal për Parandalimin e Covid-19.
2. Në Raportin si në pikën 1 të kësaj shkrese janë paraqitur aktivitetet e zhvilluara nga Shtabi Komunal për Parandalimin e Covid-19, lidhur me menaxhimin e situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19 , si dhe sfidat për parandalimin e kësaj pandemie.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është; “Raporti i Punës së Shtabit Komunal për Parandalimin e Pandemisë COVID-19 për Kuvendin Komunal në Kaçanik”, Lënda 01Nr.104/02-29676/20.

Më këtë shkrese njoftohen: Kryetari i Komunës, dhe përmes zyrës së Kryetarit njoftohen edhe Drejtoritë komunale dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



01-104/02-29676/20
26.11.2020

R A P O R T

**I PUNËS SË SHITABIT KOMUNAL PËR PARANDALIMIN E COVID-19
PËR KUVENDIN KOMUNAL NË KAÇANIK**

KAÇANIK

Hyrje:

Meqenëse situata aktuale në Kosovë dhe jo vetëm akoma vazhdon të jetë pothuajse e njejtë, ndonëse edhe më e rënduar, gjë që vërehet qartë edhe nga rritja e vazhdueshme e numrave të personave të prekur nga virusi COVID-19 si dhe nga rritja e numrit të vdekjeve si pasojë e këtij virusi Shtabi Komunal për parandalimin e këtij virusi në Komunën e Kaçanikut ende vazhdon të jetë aktiv, kështu duke kryer detyrat e tij të përcaktuara si në vendimin për themelimin e këtij shtabi.

Përbërja e Shtabit Komunal për parandalimin e COVID-19:

Anëtarët e Shtabit Komunal janë emëruar nga institucione dhe subjekte të ndryshme të komunës tonë, kështu duke angazhuar të gjithë ata të cilët në mënyrë direkte do të kontribuonin parandalimit të këtij virusi dhe menaxhimit më të situatës së krijuar.

Shtabi Komunal përbëhet nga 15 anëtar si në vijim:

1. Besim Ilazi, Kryesues i Shtabit
2. Diana Bajrami Reka- Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
3. Bahri Selimi, Drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
4. Ramadush Osmani Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
5. Fidaim Fazliu, Kryetar i Bashkësisë Islame në Kaçanik
6. Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit Komunal në Kaçanik
7. Agim Mani, Asambleist nga LVV
8. Kadri Krivanjeva, Asambleist nga PDK
9. Besnik Salihu, Asambleist nga LDK
10. Sinan Zeneli, Drejtor i QKMF- në Kaçanik
11. Naim Hysa, përgjegjës i Kryqit të Kuq në Kaçanik
12. Halim Shehu, Komandant i Stacionit Policor
13. Ylber Tusha, përfaqësues i Bizneseve
14. Bujar Bajra Zyrtar për Alarmit dhe Koordimin Emergjent
15. Besnik Bajra, Inspektor Sanitar

Mbledhjet e Shtabit Komunal:

Shtabi ka vazhduar ti mbaj takimet në bazë të nevojës si dhe në bazë të numrit të rasteve të paraqitura në Komunën e Kaçanikut, deri më tani janë mbajtur gjithësej 19 takime të shtabit komunal, që nga themelimi i këtij shtabi, ndërsa pas raportit të paraqitur më datë 24.08.2020 e deri në raportin e tanishëm të dates 26.11.2020 janë mbajtur 3 mbledhje.

Përveç takimeve shtabi ka pasur vazhdimisht kontakte edhe nëpërmjet grupit viber si dhe në formë zyrtare me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë.

Vendimet e Shtabit Komunal:

Që nga themelimi i shtabit janë marrë vendime të ndryshme të cilat janë cekur në dy raportet paraprake, në atë të datës 22.06.2020 si dhe në raportin e datës 24.08.2020.

Ndërsa pas kësaj, me datë 24.08.2020 me Vendimin nr. 01-610/01-20571/20 është formuar Task Forca në nivel të DAK.

Task Forca në nivel të DAK deri më tani ka mbajtur 11 mbledhje.

Po ashtu të gjitha Shkollat Filllore dhe të Mesme në Komunën tonë kanë themeluar Task Forc në përbërje të shkollës si dhe janë funksionale.

Të gjitha grupet e Task Forc-ave mbajnë mbledhje njëherë në javë.

Rekomandimet e Shtabit Komunal:

Vazhdojnë të mbesin po të njejtat konform kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti si:

- Të respektohet distanca sociale;
- Të kenë kujdesë qytetarët gjatë ceremonive mortore;
- Patrolla më të shumta nga ana e policisë për qytetarët që frekuenetojnë nga komunat tjera sidomos nga komunat vatra;
- Të bëhet dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike;
- Të kërkohet dezinfektimi i Dyqaneve dhe Barnatorëve nga ana e vet pronarëve;
- U kërkua nga qytetarëve të cilët vijnë për shërbime në të gjitha Institucionet Publike të vendosin maska dhe doreza;
- Të ketë patrolla nga ana e policisë nëpër fshatra dhe zona urbane;
- Të ketë kontrolla nga Inspektorati edhe nëpër dyqane nëpër fshatra dhe zona urbane;
- Të anulohen të gjitha aktivitetet komunale festive;

